

**SIGURIA KOMBËTARE E SHTETEVE TË VOGLA- RAST STUDIMI KOSOVA**

**TEMA PËR TITULLIN MASTER NË  
DREJTIMIN INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE**

**NGA**

**LEONORA BAJRAMI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE**

**Qërshor, 2021**

## **SIGURIA KOMBËTARE E SHTETEVE TË VOGLA- RAST STUDIMI KOSOVA**

Mentor. Prof. Ass. Dr. Adem Beha

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të identifikojë mjedisin e sigurisë dhe të mbrojtjes së shteteve të vogla, përfshirë Kosovën si rast studimi. Arsyeja kryesore prapa kësaj ishte arritja e një kuptimi më të mirë për marrëdhënien midis sigurisë dhe fuqisë së shteteve të vogla. Ky studim argumenton se shtetet e vogla janë të ekspozuara ndaj një sërë sfidash dhe ndikimesh të sigurisë që u mungojnë dhe që përcaktojnë sjelljen e tyre të politikës së jashtme dhe strategjitë e sigurisë. “Siguria kombëtare e tyre çënohet përshkak të brishtësisë që ato kanë në terma të fuqisë klasike”, pasi që, pavarësisht rregullave të vendosura sot në marrëdhëniet ndërkombëtare ndërmjet shteteve, shtetet e vogla nuk kanë gjasa të arrijnë shumë kur ballafaqohen me kundërshtimin e fuqive të mëdha. Pasi që, fuqia ushtarake vazhdon të jetë një faktor dominant (sot me armët bërthamore) në përcaktimin e forcës së një vendi dhe vijën e vërtetë mbrojtëse midis sigurisë dhe pushtimit në rast të një Luftë të Tretë Botërore ose të ballafaquar me konflikt shtetëror. Kësisoj, shtetet e vogla shpesh bëhen viktima të konkurrencës jo të shëndetshme të fuqive të jashtme. Gjithashtu studimi argumenton se, mjedisi i sigurisë në Kosovë është relativisht i qëndrueshëm. Dhe si i vetmi kërcënim i cili mund të shpije deri te konfliktet e armatosura për Kosovën përftohet nga politikat armiqësore të Serbisë. Kësisoj, anëtarësimi i shteteve të vogla në mekanizmat ndërkombëtar të sigurisë kolektive është garanca më e qëndrueshme për sigurinë e tyre kombëtare. Dhe se strategjia më efiçente për garantimin e sigurisë kombëtare të Kosovës është antarësimi i saj në mekanizmat euro-atlantik.

### **PËRMBLEDHJE**

Çështja e sigurisë është gjithmonë e pranishme, me befasi dhe shpërthime të papritura edhe pse njerëzit kanë paguar dhe vazhdojnë të paguajnë një kosto shumë të lartë të jetës ushtarake, monetare dhe material. Kjo u theksua edhe gjatë Luftës së Ftohtë, përmes rivalitetit të super-fuqive, konflikteve ideologjike, si dhe konfrontimeve midis tyre për interesa gjeo-politike dhe gjeo-strategjike. Po ashtu, ngjarjet e tilla si; sulmet terroriste të 11 shtatorit të 2001-ës, lufta ruso-gjeorgjiane në vitin 2008, lufta ruse kundër Ukrainës ndikoi në rritjen e pasigurive për shtetet në përgjithësi e në veçanti për shtetet e vogla. Veçanërisht lufta ruso-gjeorgjiane dhe aneksimi i Krimesë nga Rusia dhe angazhimet e mëtejshme ushtarake në pjesë të tjera të Ukrainës janë shembuj të kërcënimeve tradicionale të sigurisë që kanë të bëjnë si me mbrojtjen e integritetit

territorial të shteteve individuale, ashtu edhe me të ardhmen e rendit të sigurisë në Evropë e më gjerë. Kësisoj, dëshira për siguri, e shoqëruar me dijeninë se aleatët e tanishëm mund të jenë kundërshtarë në të ardhmen dhe se kundërshtarët e tanishëm mund të ofrojnë mbështetje në të ardhmen gjeneron shumë pasiguri të shtetet e sidomos për shtetet e vogla.

Shumica e studimeve të kryera deri më tani në fushën e shteteve të vogla - duke i trajtuar ato në pikëpamje dhe qasje të ndryshme - kanë nxjerrë përfundimin se ata kanë përgjithësisht në mendje tri bashkësi të shteteve kur flasin për shtete të vogla: "Mikroshtetet - shtetet me një popullsi me më pak se një milion banorë, siç janë ish-kolonitë britanike në Karaibe; shtetet e vogla në botën e zhvilluar - veçanërisht Austria, Belgjika, Luksemburgu dhe Zvicra; dhe shtete të vogla në të ashtuquajturën botë të tretë, përfshirë ish-kolonitë në Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine. Sidoqoftë, asnjë nga kategoritë e lartpërmendura nuk është e qartë, dhe as nuk ka marrëveshje të përgjithshme se cila prej tyre jep koordinatat e duhura për mënyrën e përcaktimit të shteteve të vogla. Për këtë, Erling Bjøl tregon se një shtet është vetëm i vogël në raport me një shtet më të madh. Sipas tij, në vetvete koncepti i shtetit të vogël nuk do të thotë asgjë. Një shtet është i vogël vetëm në raport me një më të madh. Prandaj, kur flitet për aftësinë ose paaftësinë e një shteti të dobët për të mbrojtur veten, duhet menjëherë të pyesësh, 'Kundër kujt?'. Kësisoj, secili shtet i vogël duhet të luajë më tej me forcat e veta për të ndërtuar një mjedis ku ata mund të jenë konkurrues dhe të mund të realizojnë objektivat e tyre të sigurisë dhe politikës. Kështu, fuqia e butë, fuqia derivative dhe ajo kolektive ofrojnë avatazhe për shtetet e vogla pasi që mund t'u ofrojë një fuqi shumë më të madh mbi një palë të tretë, dhe ndoshta me një kosto më të ulët. Duke analizuar shtetet e vogla me specifikat e veçanta të tyre, dalim në një përfundim tjetër mjaft të rëndësishëm se kur themi shtet i vogël, nuk duhet të nënkuptojmë se po flasim domosdoshmërisht për një shtet të dobët, pasi në sistemin ndërkombëtar është e pranishme një gamë e gjerë shtetesh të vogla.

Shtetet e vogla janë të ekspozuara ndaj një sërë sfidash dhe ndikimesh të sigurisë që u mungojnë dhe që përcaktojnë sjelljen e tyre të politikës së jashtme dhe strategjitë e sigurisë. Për shkak të madhësisë së tyre të vogël dhe aftësive të kufizuara për të mbrojtur veten ushtarakisht ose ekonomikisht, shtetet e vogla janë shumë më të prekshme nga dinamika e brendshme dhe e jashtme kur krahasohen me fuqitë e mëdha. Për të fituar më shumë siguri dhe stabilitet, si dhe për të ushtruar më shumë ndikim dhe për të përmbushur nevojat e tyre ekonomike ose politike,

shtetet e vogla ose kërkojnë partnerë dhe aleatë ose qëndrojnë asnjëherë. Secila nga strategjitë e sigurisë së shteteve të vogla synon të rrisë shanset e tyre për të mbijetuar, por gjithashtu mbart rreziqe të caktuara. Pavarësisht nga ndarja e karakteristikave të ngjashme të vogëlsisë, shtetet priren të përdorin strategji të ndryshme të sigurisë dhe modele të ndryshme të sjelljes së politikës së jashtme. Nisur nga kriteret bazë të përcaktimit të përkufizimit të shteteve dhe Kosova lehtësisht mund të klasifikohet se bën pjesë në shtetet e vogla. Sipas treguesve dhe vlerësimeve të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë, mjedisi i sigurisë në Kosovë është relativisht i qëndrueshëm. Dhe se si i vetmi kërcënim i cili mund të shpije deri te konfliktet e armatosura për Kosovën përftohet nga politikat armiqësore të Serbisë.

Si përfundim, Siguria kombëtare e shteteve të vogal çënohet përshkak të brishtësisë që ato kanë në terma të fuqisë klasike”, pasi që qysh në kongresin e Vjenës shtetet me aftësi ushtarake krijuan rregullat e lojës e shtetet e vogla në mungesë të fuqive ushtarake kishin mbetura për t’u bindur këtyre rregullave, sepse ato ishin shumë të dobëta për t’u marrë seriozisht kur rregullat u negociuan. Kësisoj, pavarësisht rregullave të vendosura sot në marrëdhëniet ndërkombëtare ndërmjet shteteve, shtetet e vogla nuk kanë gjasa të arrijnë shumë kur ballafaqohen me kundërshtimin e fuqive të mëdha. Pasi që, fuqia ushtarake vazhdon të jetë një faktor dominant (sot me armët bërthamore) në përcaktimin e forcës së një vendi dhe vijën e vërtetë mbrojtëse midis sigurisë dhe pushtimit në rast të një Luftë të Tretë Botërore ose të ballafaquar me konflikt shtetëror. Po ashtu nga analiza e të dhënave janë vërtetuar, se anëtarësimi i shteteve të vogla në mekanizmat ndërkombëtar të sigurisë kolektive është garanca më e qëndrueshme për sigurinë e tyre kombëtare. Dhe po ashtu, strategjia më efikase për garantimin e sigurisë kombëtare të Kosovës është antarësimi i saj në mekanizmat euro-atlantik.

## **PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E KAPITUJVE**

*Në kapitullin e parë* të këtij hulumtimi është përfshirë metodologjinë e hulumtimit.

*Në kapitullin e dytë* përfshihet kuadri teorik. Sqarimin e nocionit shtetet të vogla bazuar në literaturën e shteteve të vogla, ndërsa sigurinë kombëtare të shteteve të vogla është analizuar bazuar në dy teoritë e marrëdhënive ndërkombëtare (realizmi dhe liberalizmi). Po ashtu në këtë kapitull janë analizuar kategoritë e shteteve dhe historinë e krijimit të shteteve të vogla.

*Në kapitullin e tretë*, analizohen konceptet e fuqisë së shteteve të vogla. Siç janë: fuqia e fortë, fuqia e butë, ajo derivative dhe kolektive. Po ashtu analizohen kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë kombëtare të shteteve të vogla.

*Në kapitullin e katërt* shtjellohet zhvillimi i strategjive për sigurinë e shteteve të vogla. Duke analizuar politikën e jashtme, si armë e rëndësishme për sigurinë kombëtare të shteteve të vogla, balancin e fuqisë si çelësi i sigurisë së shteteve të vogla, pastaj krijimin e aleancave si përgjigje ndaj kërcënimeve. Si dhe politikën e neutralitetit, si strategji për sigurinë e shteteve të vogla.

*Në kapitullin e pestë* analizohet siguria kombëtare e Kosovës. Duke analizuar fillimisht strategjinë e sigurisë kombëtare të saj, rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë kombëtare të Kosovës. Po ashtu në këtë kapitull shtjellohet, fuqizimi i forcave të armatosura si faktor i sigurisë kombëtare të Kosovës dhe marrëdhëniet e saj me vendet e rajonit. Si dhe është analizuar ajo që konsiderohet si kusht vendimtar për sigurinë kombëtare të Kosovës, pra, përshpejtimi i procesit të integritimit në Bashkimin Europian (BE) dhe forcimi i marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

## **METODOLOGJIA**

Hulumtimi ka qasje sasiore dhe cilësore, ndërsa modeli i zgjedhur është përshkrues. Metoda e përdorur në këtë hulumtim ajo cilësore, ka si qëllim të ndihmojë në trajtimin e çështjes së marrë në shqyrtim. Kjo metodë përshtatet sepse implikon të dhëna kualitative, nëpërmjet të cilave kam arritur të siguroj kuptimin dhe elaburimin e rasteve studimore, objekteve të hulumtimit, nga spektri analitik i mbledhjes së të dhënave, duke grumbulluar informacione me qëllim analizimin e sjelljes së aktorëve, marrëveshjeve që ata kryejnë, mënyrën sesi ata veprojnë. Pra, për hartimin e këtij hulumtimi është përdorur metodën historike, metodën e analizës teorike, metodën përshkruese dhe metodën krahasimtare. Duke zgjedhur literaturë relevante përmes librave, publikimeve shkencore, raporteve të ndryshme si dhe burime interneti. Përmes metodës historike është trajtuar historikun e zhvillimit të shteteve të vogla që nga formësimi, zhvillimi dhe zhvendosja e aleancave me fuqitë rajonale e ato botërore të kohës. Për të gjitha këto është përdorur literaturë mbi sigurinë, rreziqet e kërcënimet, sfidat e sigurisë, politikat dhe aleancat me fuqitë rajonale e botërore, të shteteve të vogla dhe kryesisht të Kosovës. Punimi është ndërtuar edhe me të dhëna krahasuese e analizuese sidomos për çështje që lidhen me aleancat dhe problemet e sigurisë kombëtare, karakteristikat e përbashkëta dhe dallimet që prekin të gjithë

elementët ndikues të teorive të sigurisë kombëtare të shteteve të vogla. Gjithashtu, duke qenë se matja konkrete e ndryshimeve sa i përket fuqisë relative të një shteti është një çështje realisht e ndërlikuar, mbledhja e të dhënave konkrete dhe interpretimi i tyre bazuar në një qasje krahasuese, ka shërbyer si instrument i rëndësishëm për ta bërë sa më të besueshëm kuadrin teorik. Ndërsa, si instrumente për mbledhjen e të dhënave sasiore është shfrytëzuar pyetësori i strukturuar në formë elektronike (online), ku fokusi do të jetë mbi studentët e Universitetit të Prishtinës. Pyetësori përmban 10 pyetje të mbyllura, megjithatë në njërin prej pyetjeve u është dhënë mundësia responentëve që të japin një opsion tjetër që nuk ndodhet në pyetësor. Ku fokusi do të jetë mbi studentët e Universitetit të Prishtinës.

Hulumtimi synon të jap përgjigje në pyetjet hulumtuese:

- P.1: Cilat janë kërcënimet kryesore për sigurinë e shteteve të vogëla?
- P.2: Çfarë strategjie duhet të ndjekin shteteve të vogla për të garantuar sigurinë e tyre kombëtare?
- P.3: Çka tregon praktika e garantimit të sigurisë kombëtare të shteteve të vogla duke qenë pjesë e mekanizmave ndërkombëtar të sigurisë kolektive?